

**VENDIM**  
**Nr. 329, datë 18.5.2022**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 656, DATË 31.10.2018, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË  
ANËTARËVE TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË  
PËRHERSHME TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 3, të vendimit nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për shpërblimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit Rregullator Hekurudhor përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoriteti Rregullator Hekurudhor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

**TABELA**

Emërtesa e Bordit/Këshillit/Komisionit	Numri maksimal i pagesave për një vit	Përbërja		Masa e shpërblimit në lekë	
		Kryetari	Nr. i anëtarëve		
Këshilli Drejtues i Autoritetit Rregullator Hekurudhor	10			15,000	10,000
		1	4		